



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 578/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i përbërë nga gjyqtaret: Faton Ademi kryesues, Adnan Konushevci dhe Rustem Thaqi dhe anëtarë, si dhe me pjesëmarrjen e zyrtarit ligjor Besart Ademi, duke vendosur përkitazi me ankesën e kandidatit për deputet të Kuvendit të Republikës së Kosovës Rrahman Jakupi kandidat për deputet nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), paraqitur kundër rezultatit përfundimtar të publikuar nga KQZ-ja me datë 04.03.2021, për Zgjedhjet e Parakohshme Parlamentare, të mbajtura me datë 14.02.2021 në seancën e panelit të mbajtur me 05.03.2021, mori këtë:

## V E N D I M

**I. Pranohet** e bazuar apeli Anr.578/2021, i Kandidatit për deputet të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Rrahman Jakupi nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK).

**II. Urdhërohet** Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) që të rinumëroj vetëm fletëvotimet për kandidatët për deputet të subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), në Vendvotimin 2202E/01R.

**III. Rezultati** i cili del pas rinumërimit të kutive të votimeve në Vendvotimet si në pikën -II- të këtij dispozitivi, të përfshihen në rezultatit përfundimtar.

## A R S Y E T I M

PZAP-i, ka pranuar një ankesë më datë 04.03.2021, nga kandidati për deputet të Kuvendit të Republikës së Kosovës Rrahman Jakupi nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me të cilën pretendon se ka pasur shpërputhje të rezultateve në formularin e rezultateve të kandidatëve në vendvotimin 2202E/01R në SHFM "BajramCurri" në Petrovë ku pretendon se në formularin e rezultateve të kandidatëve është bërë një ngatërrim i votave nga se në atë vendvotim siç pretendon ka 113 vota sipas raportimit të vëzhguesve, ndërsa në FRK, është theksuar vetëm numri 13 e jo edhe nr 1 përpara (1)13 e që u vërtetua edhe në shpalljen e rezultateve përfundimtare nga KQZ. Sipas parashtresës të ankesës subjekti i tij politik në atë vendvotim ka marrur gjithsejt 156 vota.

Parashtresë i ankesës në cilësinë e provës si dëshmi ka bashkangjitur kopjet e FRK-ve për vendvotimin në të cilin pretendon se ka pasur parregullsi.

Formularët e Rezultateve të Kandidatëve të ofruara nga parashtresë i ankesës lidhur me rastin në fjalë janë formularët e vendvotimeve me numër 2202 E /01R.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashpresa (PZAP), i shqyrtoj pretendimet ankimore dhe materialin zgjedhor e pas vlerësimit të gjithanshëm të tyre gjeti se:

### **Ankesa është e bazuar**

Paneli gjeti se pretendimet ankimore janë të bazuara, pasi që pas shqyrtimit të provave dhe shkresave të lëndës, ka konstatuar se ka mospërputhje të rezultateve të shpallura nga KQZ-ja me Formularët e Rezultateve të Kandidatëve dhe Formularit Përfundimtar të Rezultatit, siç rezulton edhe nga provat e ofruara si: dëshmi nga vetë pala ankuese, ku shihet se në FRK janë të shënuara gjithsej 156 vota, të subjektit politik PDK, ndërsa në listën e numërimit të kandidatëve, kandidati i këtij subjekti Rrahman Jakupi ka të shënuar nr.13 i cili numër nuk është i qartë. Andaj mbi këtë bazë dhe në mbështetje të nenit 117.4 të LZP-së, PZAP-i urdhëron KQZ-në, që të bëhet rinumërimi i të gjitha fletëvotimeve për kandidatët nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), në këtë vendvotim si në vijim: 2202E/01R, dhe rezultati i dalur nga rinumërimi të përfshihet në rezultatin përfundimtar të Zgjedhjeve të Parakohshme Parlamentare 2021.

Andaj PZAP nga këto arsye, dhe në mbështetje të nenit 117.4 urdhëron që të bëhet rinumërimi i fletëvotimeve për vendvotimin e lartcekur.

Prandaj më qëllim të evitimit të këtyre lëshimeve të lartë cekura dhe bazuar në nenet 115.1, dhe nenin 119.5 të LZP-së, ku parashihet se, *PZAP-i mundet që sipas vendimit të tij të shqyrtoj çështje të cilat përndryshe janë nën juridiksionin e tij kur kjo është rreptësisht e domosdoshme për të parandaluar padrejtësi serioze* po ashtu lidhur me nenin 118 paragrafi 1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

### **Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashpresa**

A nr. 578/2021 më datën 05.03.2021



### ***Këshillë Juridike:***

*Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve, nga momenti i marrjes-pranimit të këtij vendimi.*